



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite – Ministry of Labour and Social Welfare

Marrëveshje Bashkëpunimi

mes

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)
Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK)

Dhe

KOMUNA E VUSHTRRIË

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) / Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), E PËRFAQËSUAR NGA Z. Feim Osmani, UD Sekretar i Përgjithshëm i MPMS.

Dhe

Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga z. Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës

Lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi sipas dispozitave në vijim:

Neni 1

Hyrje

Duke ju referuar ligjit 05/L-077 dhe Ligjit 04/L-205, dhe me qëllim të krijimit të partneritetit me aktorët e tjerë palët e sipërpërmendura pajtohen që të bashkëpunojnë rreth realizimit të masës Praktikë në Punë konform Rregullores 01/2018, për masën aktive të tregut të punës lidhur me realizimin e kësaj mase aktive të tregut të punës.

Neni 2

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit (më tutje: marrëveshja), ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (më tutje: MPMS), Komunës së Vushtrrisë, është realizimi i masës Praktikë në Punë në Komunën e Vushtrrisë, (më tutje Komunës së Vushtrrisë,) për 14 (katërmbëdhjetë) punëkërkuesve të regjistruar në kuadër të Zyrave të Punësimit, për një periudhë kohore 6 (gjashtë) mujore;
2. Praktikë në Punë (PNP) iu ofrohet pjesëmarrësve mundësin e fitimit të përvojës së nevojshme në mjedisin e punës për të filluar në një profesion të caktuar ose një fushë të karrierës.

Neni 3

Fushëveprimi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi përcakton termet dhe kushtet e bashkëpunimit në mes të MPMS/ APRK dhe Komunës së Vushtrrisë, në zhvillimin- realizimin e praktikës në punë për 14 (katërmbëdhjetë) punëkërkues, për 6 (gjashtë) muaj.
2. Projekti i aktiviteteve si në nenin 1 të Marrëveshjes do të angazhoj 14(katërmbëdhjetë) punëkërkues për 6 (muaj) radhazi me kompensim mujor prej 170 €, të cilët janë të regjistruar si punëkërkues në Zyrën e Punësimit, në kuadër të APRK. Vlera e përgjithshme e projektit do të jetë 14.280 (katërmbëdhjetëmijë e dyqind e tetëdhjetë)€.
3. Praktika në Punë do të realizohet pranë zyrave përkatëse të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 4

Baza e Bashkëpunimit

Bazë e bashkëpunimit për realizimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit është legjislacioni i aplikueshëm i Republikës së Kosovës, nga fusha e tregut të punës.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e MPMS/APRK-së

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e MPMS/ APRK janë si në vijim:
 - 1.1. Të sigurojë mjetet financiare në vlerë prej 14.280 (katërmëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) € për kompensimin e punëkërkuesve të angazhuar në Praktikën në Punë në vlerën prej 170 € në muaj për 1(një) praktikantë, si dhe të bashkëpunon me Komunën e Vushtrrisë, lidhur me realizimin e detyrave nga Marrëveshja e Bashkëpunimit në fjalë;
 - 1.2. Të paguaj kompensimin për 14 (katërmëdhjetë) punëkërkuesit e angazhuar në shumën prej 170.00 € (njëqind e shtatëdhjetë) për muaj, kompensim ky që bëhet në xhirollogarinë bankare të pjesëmarrësit në praktikë në punë;
 - 1.3. Të përzgjedhë së bashku me Komunën e Vushtrrisë,, punëkërkues nga lista e punëkërkuesve të regjistruar, të përgatitë listën e gjërë dhe të sigurojë marrëveshjet e angazhimit në masën praktikë në punë për punëkërkuesit e angazhuar sipas Marrëveshjes;
 - 1.4. Zyra e Punësimit në emër të APRK nënshkruan marrëveshjen për realizimin e masës e cila përmban të drejta dhe detyrime të palëve që marrin pjesë në implementimin e masës aktive,
 - 1.5. Përcaktimi i dinamikës së aktiviteteve për realizimin e masës Praktikë në Punë dhe në bashkëpunim me Komunën e Vushtrrisë, të përcaktoj lokacionin se ku duhet të angazhohen punëtorët;
 - 1.6. Angazhimi i 1 punëkërkuesi person me aftësi të kufizuar edhe punëkërkues të cilët janë shfrytëzues të asistencës sociale të kategorisë së II, sipas mundësive të cilët gjatë kohës sa janë të angazhuar në projekt do t`u ndërpritet asistenca sociale, kur kemi raste të tilla që plotësojnë kriteret;
 - 1.7. Të monitoroj mbi baza ditore, javore dhe mujore vijueshmërinë e punëtorëve në punë, dhe të pranoj rregullisht listat e nënshkrimeve të vijueshmërisë nga përfaqësuesit e Komunës së Vushtrrisë;
 - 1.8. MPMS/ APRK nuk është përgjegjëse për ndonjë shpenzim nga ndonjë dëmtim të paisjeve në punë, shpenzimet nga aksidentet apo sëmundja e pjesëmarrësit gjatë implementimit të masës;

Neni 6

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës së Vushtrrisë;

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës së Vushtrrisë janë:
 - 1.1. Bashkëpunon me MPMS/APRK në realizimin të Praktikës në Punë për 14 (katërmëdhjetë) punëkërkues;
 - 1.2. Komuna e Vushtrrisë do të caktoj personel nga administrata i/e cili/a do të marrë pjesë në procesin e përzgjedhjes së punëkërkuesve të regjistruar që do të angazhohen në praktikë në punë, si dhe do të përcjellë angazhimin, mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e praktikantëve mbi baza ditore;
 - 1.3. Komuna pajtohet se gjatë praktikës do të sigurojë një mjedis të sigurt dhe mbrojtje e siguri në punë në përputhje me Ligjin Nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës;
 - 1.4. Siguron që praktikantët gjatë angazhimit të tij 6 (gjashtë) mujor do të përvetësojnë njohurit dhe shkathhtësitë themelore të punës në zyre – administratë dhe se do të jenë të gatshëm për tregun e punës pas përfundimit të angazhimit;
 - 1.5. Bashkërisht me APRK/ZP përcakton departamentet se ku do të caktohen praktikantët varësisht nga profili i tij dhe përcaktimi i aktiviteteve për praktikë në Punë;
 - 1.6. Komuna do të njoftojë Zyrën e Punësimit nëse ai/ajo nuk është i kënaqur me praktikantët brenda 10 ditëve të para kalendarike të vendosjes (periudhës së provës) dhe mund të kërkojë zëvendësim. Nuk do të ketë kompensim për periudhën provuese;
 - 1.7. Në rast se Komuna ndërprente marrëveshjen me praktikantin/en brenda periudhës së përcaktuar, Komuna merr përsipër të informojë Zyrën e Punësimit me shkrim menjëherë;
 - 1.8. Mundëson monitorimin e realizimit të masës praktikë në punë nga ana e zyrtareve të Zyrës së Punësimit përkatëse dhe njofton MPMS/APRK lidhur me sfidat dhe vështërsitë e mundshme gjatë realizimit të praktikës në punë;
 - 1.9. Shqyrton, aprovon dhe nënshkruan listën e vijueshmërinë së praktikantit/es dhe njofton çdo muaj Zyren e Punësimit në mënyrë që të procesohet pagesa për kompenzim;
 - 1.10. Lëshon letër reference për praktikantët që kanë kryer me sukses PNP-në.

Neni 7

Mos pajtimet dhe paqartësitë

1. Secila palë nënshkruese e marrëveshjes mund ta ndërprejë marrëveshjen brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit me shkrim, nëse pala tjetër nuk është në gjendje apo në ndonjë mënyrë pengohet në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësi të veta sipas marrëveshjes, duke vënë në rrezik arritjen e objektivave të projektit, me kusht që palët janë konsultuar, por pa sukses në përpjekje për të eliminuar pengesën.
2. Pas njoftimit për ndërprerje, siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, palët menjëherë marrin hapat e nevojshëm për të finalizuar aktivitetet e tyre sipas marrëveshjes, duke e bërë këtë sa më shpejtë dhe në mënyrë të organizuar me qëllim të minimizimit të humbjeve dhe shpenzimeve shtesë.

Neni 8

Modifikimi i marrëveshjes apo shkëputja e saj

1. Kjo Marrëveshja e Bashkëpunimit, mund të modifikohet apo të shfuqizohet në mënyrë automatike me hyrjen në fuqi të ndonjë ligji, fushëveprimi i të cilit prek ndonjë nga pikat e kësaj Marrëveshje, apo aktet tjera nënligjore dispozitat e të cilave janë në kundërshtim me këtë Marrëveshje.
2. Çdo ndryshim eventual i kësaj Marrëveshjeje bëhet në pajtim nga dy palët dhe do të shtohet si aneks dhe hynë në fuqi me nënshkrimin nga përfaqësuesit e Institucioneve që zbatojnë këtë Marrëveshje.
3. Secila nga palët mund të tërhiqet nga Marrëveshja brenda tridhjetë (30) ditëve pas paralajmërimit me shkrim duke i dhënë argumentet përkatëse;
4. Kohë e paralajmërimit do të merret data e pranimi të letrës paralajmëruese.

Neni 9

Anekset e marrëveshjes

Plani i detajuar i aktiviteteve do të zhvillohet nga të dy palët pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje.

Neni 10
Hyrja në Fuqi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet më datën 17.09.2020, në Prishtinë, Republika e Kosovës, në dy (2) ekzemplar origjinale, nga një për së cilën palë nënshkruese.
2. Kjo Marrëveshje do të fillojë së zbatuari nga data: 01. 10. 2020, dhe do të zgjasë deri me datë 31. 03. 2021.

PALËT NËNSHKRUESE

Për: MPMS/APRK:
Z. Feim OSMANI



u.d Sekretari i Përgjithshëm i MPMS



Për: Komunën e Vushtrisë
Z. Xhafer TAHIRI



Kryetar i Komunës Vushtrri